




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
2-0/DPK	01-5052/14
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	29.12.2014
PRISHTINE	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-3968/14, qe për trajtim ka pas zyrtarin e lartë z. Faton Ahmetaj, Drejtor i Departamentit të Planifikimit dhe Raportimit Financiar në Bankën Qendrore të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3968/14, qe për trajtim ka pasur zyrtarin z. Faton Ahmetaj, Drejtor i Departamentit të Planifikimit dhe Raportimit Financiar në Bankën Qendrore të Kosovës.

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari z. Faton Ahmetaj, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si zyrtar i lartë, Drejtor i Planifikimit dhe Raportimit Financiar në Bankën Qendrore të Kosovës, është i angazhuar në veprimtari private si person i autorizuar, në një biznes privat e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm të interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin të funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 17.11.2014 e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Faton Ahmetaj, ka ardhur ne takim ku është takuar me zyrtarët e AKK-së, dhe i janë prezantuar faktet qe disponon Agjencia lidhur me dyshimin për konflikt të mundshëm të interesit.

z. Ahmetaj, gjatë takimit është pajtuar me gjendjen, por na ka njoftuar se biznesi ne fjalë nuk zhvillon aktivitet dhe ka mbetur vetëm si biznes i regjistruar në ARBK, dhe është zotuar se brenda afatit ligjore do ti kërkoj pronarit të këtij biznesi qe të largoj nga regjistri si person i autorizuar i këtij biznesi.

Me datën 26.12.2014, kemi marr njoftimin zyrtar nga ARBK-ë, ku dëshmohet se është bër ndryshimi i kërkuar nga z. Ahmetaj, dhe aji nuk figuron më si person i autorizuar në biznesin privat më emër "D.P.T-Blerimi" dhe nr 70395313.

Vlerësojmë se pas ndryshimeve të bëra në biznes, dhe pas rrethanave te krijuara konsiderojmë se është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit për zyrtarin z. Faton Ahmetaj, Drejtor i Departamentit të Planifikimit dhe Raportimit Financiar në Bankën Qendrore të Kosovës, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

